

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika MonoTop® Dynamic HP

LLAÇ ME 1 PËRBËRËS ME PERFORMANCË TË LARTË DHE I PËRFORCUAR ME FIBRA PËR RIPARIME STRUKTURE



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop® Dynamic HP është llaç çimentoje me 1 përbërës gati për përdorim, me tiksotropi të lartë dhe veti të balancuara tkurrjeje, i cili përdoret për punime riparimi me performancë të lartë dhe plotëson kërkesat e kategorisë R4 të EN 1504-3.

Përmban çimento të modifikuar me polimere sintetike, tym silici (silica fume), agregate të përzgjedhura dhe fibra sintetike.

### PËRDORIMET

- Performancë e lartë riparimesh strukturore dhe aplikime suvatimi në elementet prej betoni
- Punime riparimi dhe finiture të elementeve të parafabrikuara
- Ideal për punime riparimi përpara sistemeve FRP për përforcim strukturor Sika® Carbodur ose SikaWrap®
- I përshtatshëm për punime restaurimi (Parimi 3, Metoda 3.1, EN 1504-9). Riparim i betonit të copëtuar dhe dëmtuar në ndërtesa, ura, punime infrastrukturore dhe superstrukturore
- I përshtatshëm për përforcim strukturor (Parimi 4, Metoda 4.4, EN 1504-9). Rritje e kapacitetit bartës të strukturës prej betoni me shtim llaçi.
- I përshtatshëm për ruajtje apo restaurim të pasivitetit (Parimi 7, Metoda 7.1 & 7.2, EN 1504-9). Rritje e mbulimit me llaç apo beton shtesë, ose me zëvendësim të betonit të kontaminuar apo të karbonuar.

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kategoria R4 sipas EN 1504-3
- Për trashësi aplikimi ndërmjet 5 mm dhe 30 mm me aplikim manual (për shtresë) ose deri në 45mm me aplikim spërkatjeje të lëngët
- Punueshmëri e mirë dhe tiksotropi e shkëlqyer
- Riparime me performancë të lartë me sipërfaqe përfundimtare cilësore, reduktim i dukshëm i kohëve të punës
- Rezistenca të larta mekanike dhe ndërkapje e shkëlqyer
- Kompensim i jashtëzakonshëm i tkurrjes
- Ideal për aplikime tavanore
- Përshkueshmëri ekstremalisht e ulët dhe rezistencë e lartë ndaj karbonimit për riparime me qëndrueshmëri të rritur, ideal për përdorim në zona pranë detit dhe/ose industriale
- Aplikim i testuar në lëkundje të vazhdueshme (ngarkesë dinamike e drejtpërdrejtë)

### MIRATIME / STANDARDE

Llaç riparimesh PCC për riparim strukturor të strukturave prej betoni në ndërtesa dhe vepra të inxhinierisë së ndërtimit, Kategoria R4 sipas EN 1504-3:2005. Parimet 3, 4 & 7, Metodat, 3.2, 4.4, 7.1 & 7.2 sipas EN 1504-9:2008. Deklaratë performance 79537588 dhe mbart markën CE.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento Portland, agregate të përzgjedhura, tym silici, polimere, aditivë.
Ambalazhi	Thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri me fibra
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit

<b>Kushtet e magazinimit</b>	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur, të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga lagështia.	
<b>Dendësia</b>	Dendësia e llaçit të freskët: ~ 2.1 kg/lit	(EN 1015-6)
<b>Përmasa maksimale e kokrrizës</b>	~ 1.5 mm	
<b>Përmbajtja në jone të tretshme kloruri</b>	≤ 0.05 %	(EN 1015-17)

## TË DHËNA TEKNIKE

<b>Rezistenca ndaj ngjeshjes</b>	<b>1 ditë</b>	<b>7 ditë</b>	<b>28 ditë</b>	<b>Kërkesat R4,28 ditë</b>	(EN 12190)
	≥ 28 MPa	≥ 42 MPa	≥ 52 MPa	≥ 45 MPa	
<b>Moduli i elasticitetit në ngjeshje</b>	<b>Rezultatet</b>		<b>Kërkesat (R4)</b>		(EN 13412)
	20.4 GPa		≥ 20 GPa		
<b>Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje</b>	<b>1 ditë</b>	<b>7 ditë</b>	<b>28 ditë</b>		(EN 196-1)
	≥ 4 MPa	≥ 6 MPa	≥ 8 MPa		
<b>Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje</b>	≥ 2.0 MPa				(EN 1542)
<b>Tkurrja / bymimi i kontrolluar</b>	≥ 2.0 Mpa				(EN 12617-4)
<b>Aplikim tavanor</b>	≥ 2.0 MPa				(EN 13395-4)
<b>Reagimi ndaj zjarrit</b>	Euroclass F				
<b>Absorbueshmëria kapilare</b>	≤ 0.5 kg /m <sup>2</sup> x v/h				(EN 13057)
<b>Rezistenca ndaj karbonimit</b>	dk ≤ beton kontrolli (MC (0.45))				(EN 13295)

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

<b>Struktura e sistemit</b>	Sika MonoTop® Dynamic HP është pjesë e serisë së llaçeve Sika që plotësojnë pjesën përkatëse të Standardit European EN 1504 dhe përbëhet nga: <b>Prajmer / Mbrojtja kundër korrodimit të armaturës:</b> Sika MonoTop®-910 N Përdorim normal (EN 1504-7) SikaTop® Armatec®-110 EpoCem® Kërkesa të larta (EN 1504-7) <b>Llaç meremetimi:</b> Sika MonoTop® Dynamic HP Kategoria R4 riparim betoni manualisht ose me pajisje <b>Llaç nivelimi / Izolues poresh:</b> Sika MonoTop®-621 Evolution Përdorim normal (EN 1504-2) Sikagard®-720 EpoCem® Kërkesa të larta (EN 1504-2 & EN 1504-3)	
-----------------------------	---	--

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

<b>Raporti i përzierjes</b>	3.8 – 4.4 lt ujë për thes 25 kg
<b>Konsumimi</b>	~ 1.80 kg/m <sup>2</sup> /mm, në varësi të ashpërsisë së nënshtresës dhe trashësisë së shtresës së aplikuar.
<b>Trashësia e shtresës</b>	5-30 mm për aplikim manual, 5-45 mm për aplikim me spërkatje të lëngët
<b>Temperatura e mjedisit</b>	min. + 5°C / max. + 35°C
<b>Temperatura e nënshtresës</b>	min. + 5°C / max. + 35°C
<b>Koha e punueshmërisë</b>	~ 45 min (në +20°C)

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

#### Betoni:

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme, të jetë plotësisht e pastër dhe pa ndryshk, papastërti dhe materiale të lira, ndotje sipërfaqësore si vaji, graso, kore betoni të cilat reduktojnë lidhjen ose parandalojnë përthithjen apo lagjen. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes duhet të jetë > 1.5MPa. Betoni i shpetëzuar, i dobët, i dëmtuar dhe i shkatërruar dhe aty ku është e nevojshme edhe betoni i shëndetshëm, duhet të hiqet me mjetet e përshtatshme.

Ashpërsoni sipërfaqen e aplikimit derisa të ekspozohen agregatet mbi sipërfaqe deri në 2 mm në përputhje me EN 1766 ose CSP 5 nga Udhëzimet ICRI.

#### Armatūra prej çeliku:

Sipërfaqja e çelikut duhet të pastrohet nga ndryshku, llaçi, mbetjet e betonit, vaji, grasoja, pluhuri dhe materiale të tjera të lira të cilat mund të reduktojnë ngjitjen ose të krijojnë korrodimin.

Në rast ndryshku, pastroni të gjithë perimetrin e shufrave të çelikut (ku është e aplikueshme) me teknika pastrimi me rrymë abrazive ose ujë me presion të lartë deri në Sa 2½ në përputhje me ISO 8501-1.

Mbroni shufrat e pastruara nga kontaminimi i mëtejshëm, përpara aplikimit të llaçit.

#### Betoforma:

Çdo betoformë duhet të ketë kapacitet mbartjeje të ngarkesës dhe forcave të ushtruar mbi të.

Betoforma duhet të jetë e pastër dhe e vendosur në pozicion pas përgatitjes së nënshtresës dhe armaturës. Disarmantët si seria Sika® Separol®, duhet të aplikohet përpara vendosjes në pozicion për të shmangur kontaktin me nënshtresën e përgatitur.

*Për kërkesa specifike duhet të referoheni gjithashtu në EN1504-10.*

### PËRZIERJA

Sika MonoTop® Dynamic HP mund të përzihet me përzierës elektrik dore në shpejtësi të ulët (~ 500 r.p.m.) për 1 deri në 2 qese, ose me përzierës me kovë për 2 deri në 3 thasë - dhe më tepër - menjëherësh, në varësi të llojit dhe përmasës së përzierësit.

Hidhni ujin në raportin e saktë brenda një konteineri të përshtatshëm për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni pluhurin tek uji dhe përzieni plotësisht për të paktën 3 minuta, duke hedhur ujë shtesë gjatë kohës së përzierjes nëse nevojitet deri në sasinë maksimale të specifikuar, derisa të përftohet një konsistencë homogjene dhe pa kokrriza. Për rezultate më të mira përzieni të gjithë thesin.

25 kg pluhur Sika MonoTop® Dynamic HP përzihet me 3.8 - 4.4 lt uji në varësi të konsistencës së kërkuar.

### APLIKIMI

Sika MonoTop® Dynamic HP mund të aplikohet manualisht ose me teknika tradicionale ose mekanikisht duke përdorur një pajisje për spërkatje të lëngshme.

#### Përdorim pa prajmer:

Lagni paraprakisht të gjithë nënshtresën e përgatitur, rekomandohet 2 orë përpara aplikimit të Sika MonoTop® Dynamic HP.

Mbajeni sipërfaqen të lagësht dhe mos lejoni që të thahet. Përpara aplikimit largoni ujin e tepërt p.sh me një sfungjer të pastër. Sipërfaqja duhet të ketë pamje të errët dhe mat ose tharje të ngopur të sipërfaqes (saturated surface dry, SSD) dhe poret nuk duhet të përmbajnë ujë.

Kur aplikoni manualisht, aplikoni shtresën e parë duke hedhur me forcë llaçin për riparim mbi nënshtresë për të formuar një shtresë të hollë dhe për të mbushur poret apo vrimat mbi sipërfaqe. Sigurohuni se e gjithë sipërfaqja që do të riparohet është mbuluar nga shtresa fillestare.

Aplikoni Sika MonoTop® Dynamic HP me mallë për riparime të vogla (riparime betoni, dekorime, skaje kolonash, etj.) tek nënshtresa që është lagur (siç referohet më sipër), duke ushtruar shumë presion dhe duke ngjeshur mirë llaçin tek nënshtresa. Mbushni të gjitha boshllëqet prapa shufrave të armaturës.

Ndërtoni shtresat nga fundi në krye duke shtypur llaçin fort mbi zonën ku do të bëhet riparimi.

Për mbulimin e sipërfaqeve të mëdha, aplikimi mund të kryhet gjithashtu me spërkatje të lëngshme me makineri standarde spërkatjeje (p.sh. Turbosol, Putzmeister). Gjatë spërkatjes sigurohuni se llaçi mbulon të gjithë perimetrin e shufrave të armimit duke mos lënë hapësira në pjesën e pasme të shufrave.

#### Përdorim në kombinim me prajmer:

Mbi një nënshtresë të mirëpërgatitur dhe të ashpërsuar, në përgjithësi nuk kërkohet prajmer për këtë produkt, por është gjithnjë e rekomanduar. Prajmeri duhet të aplikohet mbi një nënshtresë paraprakisht të lagur dhe aplikimi i rradhës i Sika MonoTop® Dynamic HP duhet të bëhet i lagësht mbi të lagësht me prajmerin.

Kur kërkohet përdorim prajmeri (sidomos kur shufrat e armimit kanë nevojë për trajtim korrodimi), referohuni tek Informacionet mbi Sistemin për produkte Sika kompatibël dhe tek skeda teknike për udhëzime.

#### Mbrojtje kundër korrodimit të armaturës:

Aty ku kërkohet veshje për armaturën (p.sh. Sika MonoTop®-910 ose SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®) referohuni tek Informacionet mbi sistemin dhe në skedën teknike përkatëse për më shumë informacione të detajuara.

Në përgjithësi, aplikoni llaçin për mbrojtje kundër korrodimit të armaturës në dy shtresa duke përdorur teknikën e dy furçave ose pistoletë me hinkë mbi armaturën (një shtresë me afërsisht 1mm trashësi). Aplikoni shtresën e parë mbi armaturën e ekspozuar. Pritni derisa shtresa e parë të jetë e fortë në prekje me thoin e gishtit, që të mos fshihet gjatë aplikimit të shtresës së dytë. Aplikoni një shtresë të dytë mbi armaturën e veshur dhe mbi betonin rrethues që do të riparohet. Aplikoni Sika MonoTop® Dynamic HP kur

shtresa e dytë e mbrojtjes kundër korrodimit të armaturës është ende e lagësht (i lagësht mbi të lagësht).

#### **Ndërtimi i shtresave (shtresëzimi):**

Trashësia e aplikimit duhet të jetë ndërmjet 0.5 dhe 3.0 cm për aplikimet manuale. Trashësitë më të mëdha mund të arrihen me spërkatje të lëngët ose manualisht me shtresa të njëpasnjëshme. Shtresa e parë duhet të ngurtësohet dhe reaksioni ekzotermik i materialit duhet të përfundojë. Shtresa e parë duhet të jetë mpiksur dhe të jetë në temperaturë ambiente përpara aplikimit të shtresës së dytë.

Mos lëmoni shtresën e parë përpara aplikimit të shtresës së dytë. Shtresa e parë duhet të pastrohet me ujë në presion të ulët ose ajër të kompresuar përpara aplikimit të shtresave pasuese të llaçit.

#### **Finitura:**

Sipërfaqja mund të përfundohet sipas kërkesave me mallë të sheshtë ose për suvatim ndërsa është e lagësht, ose me një mistri suvatimi sapo llaçi të nisë të ngurtësohet. Mos punoni mbi sipërfaqen e finituruar.

#### **METODA E MATURIMIT**

Mbroni produktin e freskët të aplikuar nga dehidratimi i hershëm dhe/ose tharja e parakohshme duke përdorur metoda të përshtatshme trajtimi (të paktën për 24 orë), p.sh. përbërës trajtimi si Sika® Antisol® ose Sikafloor® Proseal sapo të ketë avulluar uji mbi sipërfaqe.

#### **MIRËMBAJTJA E MJETEVE**

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

#### **KUFIZIME**

- Referohuni tek Sika Method of Statement për "Riparimin e betonit me përdorimin e llaçeve Sika®" (Ref.8503201) për më shumë informacione rreth aplikimit të sistemit të riparimit, përgatitjes së sipërfaqes dhe/ose referohuni tek rekomandimet që jepen në EN1504-10
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar
- Mos shtoni çimento apo substanca të tjera që mund të ndikojnë mbi vetitë e llaçit
- Mos shtoni ujë apo llaç të freskët tek një miksturë llaçi e cila ka filluar të mpikset
- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ ose erë të fortë
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresë të qëndrueshme dhe të përgatitur
- Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrirja dhe shiu
- Mos hidhni ujë shtesë gjatë finiturës së sipërfaqes pasi kjo gjë do të shkaktojë çngjyrosje dhe plasaritje
- Për aplikime tavanore mos tejkaloni 25 mm trashësi shtrese për aplikim manual dhe 40 mm për aplikim me spërkatje
- Regjistroni temperaturat e ambientit dhe nënshtresës përpara dhe gjatë aplikimit

#### **BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT**

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

#### **KUFIZIME LOKALE**

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

#### **EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI**

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika MonoTop® Dynamic HP  
Mars 2019, Botimi 03.01  
020302040030000272

SikaMonoTopDynamicHP-sq-AL-(03-2019)-3-1.pdf